



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/03-19986 dt. 17/05 2021

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt. 24.05.2021 (e hënë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt.21.04.2021.
2. Raporti i përditësuar epidemiologjik i Komunës së Drenasit lidhur me pandeminë me Covid-19 (vir.SARS-COV2) Mars-Maj 2020-2021 si dhe procesi i deritanishëm i imunizimit-(vaksinimit)
3. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikës.
4. Propozim-Diskutim i Raportit të punëve të Kompanive KRM "Pastrimi" dhe KRU-"Prishtina" në Drenas.
5. Të ndryshme .

Drenas, 17.05.2021

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

Nr. 12.060-19951 dt. 12.05 2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 21.04.2021, ora 10:00.

Mbledhjen ë kryesoi: Labinot Halilaj- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi si dhe prezent gjatë këtij takimi ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Drejtori i financave Shyqeri Bublaku dhe përfaqësues të Handikos-it.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rënd dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.03.2021.
2. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar-Mars 2021.
3. Raport i ndihmave dhe subvencioneve për vitin 2020.
4. Propozim Vendimi për bartjen të hyrave vetanake nga viti 2020, në vitin 2021.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal - Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Kryetari i Komunës. Z Ramiz Lladrovci- njoftoi se ndoshta do të ketë edhe një pikë shtesë në mbledhjen e rregullt të kuvendit, unë e kam bërë një vendim e kam autorizuar një komision për ta bërë një ekspertizë për heqjen e taksës se operimit për këtë vit, gastronomisë që i kanë bërë terasat për shkak se nuk kanë pas punë, dhe duhet me e bërë një ekspertizë komisioni, komisioni do ta bëjë raportin, se nëse ne nuk e heqim tani taksën, fillojmë me fatura dhe më nuk mundën me e tërheq taksën e operimit për të gjitha bizneset sikur vitin e kaluar, ose edhe pika tjera se kemi gjet pronë të cilat janë dhënë në shfrytëzim nga komuna që nuk i kanë plotësuar dhe përmbush kriteret ka mundësi që ia propozoj kuvendit.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, e falënderoj kryetarin që i paralajmëroj për pika shtesë, mirëpo ka të drejt ligjore me shtu edhe pika tjera, kryesuesi hodhi në votim këtë rend dite: prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë, ku votuan në mënyre anonime të gjithë anëtarët e K.P.F-ca: 7 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.03.2021**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë dhe votuan me: 7 vota për, 00 vota kundër, 00 abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal - Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2.Raporti financiar I zhvillimit të buxhetit Janar-Mars 2021.**

Drejtori i Financave Shyqeri Bubluku, raporti financiar janar-mars i vitit 2021, është si obligim i zyrës së kryetarit të paraqet para kuvendit dhe para komitetit për politikë dhe Financa, koha e raportimit është deri në javën e tretë të muajit prill, ne e kemi hartuar këtë dhe e kemi dërguar për Ministri të Financave ku pjesë e këtij raporti është edhe raporti i progresit fizik dhe financiar të investimeve kapitale. Në raport në pika të shkurta janë të paraqitura të gjitha, ligji për menaxhimin e financave dhe përgjithësitë e përcakton kohën e raportimit dhe formën e raportimit, do të ndalem në dy pikat kryesore në shpenzimin e buxhetit dhe realizimin e të hyrave. Si pikë e parë po e marrë realizimin e të hyrave ku për periudhën raportuese janar-mars 2021 realizimi i të hyrave është 265.582.76 € apo 81.8 % përqindja e realizimit për këtë periudhë kohore, trendi i realizimit është nën planifikimin nuk është qind për qind, këto janë vetëm për të hyrat direkte, mirëpo nëse i marrim edhe të hyrat indirekte për periudhën janar-mars kemi të realizuara 370.000.300 € që nuk i kanë në raport sepse na kanë ardh shënimet e gjithë komunikacionit me vonës dhe nuk janë pjesë e raportit. Mirëpo për këtë periudhë janë 370.000.356 € të realizuara. Sa i përket shpenzimit të buxhetit do ndalem vetëm tek Kuvendit Komunal mos me u marrë me gjitha drejtoritë, pagat janë qind për qind të realizuara, mallra dhe shërbime janë 14.97 %, 28.82% janë komunalit, 25.75 janë subvencionet dhe 14.26 % i kemi investimet kapitale. Kjo është në pika të shkurta për raportin financiar.

Burim Bujupi, pyeti: tek të hyrat vetanake e kam shikuar kemi në bazë të trendit 6.13 % rritje, nëse e krahasojmë me periudhën e vitit 2020, por kemi rënie në majin shkurt, kërkoj një sqarim?

Drejtori i Financave-Shyqeri Bublaku, muaji shkurt është muaji më i shkurt dhe çdo here kemi mungesë të realizimit të hyrave, realizimit të shpenzimeve sepse është periudhë kohore e shkurt në aspektin kohor mirëpo edhe në realizim të hyrave është e shkurt, shpenzimet e fund vitit ndikojnë që hyrat materiale të shpenzohen për periudhën e fund vitit.

Burim Bujupi, nuk besoj se qëndron kjo arsyeja sepse nëse e krahasojmë me vitin 2020 dhe vitin 2019 e shikojmë se në muajin shkurt kemi pas trend më të madh të rritjes ndërsa në muajin janar dhe mars kemi pas rënie, për muajin mars kuptohet ka qenë fillimi pandemisë.

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku, nëse e shikojmë vitin e kaluar ka pas rritje 48 mijë 700 € ndërsa për këtë vit i ke 88 mijë 924 €, nuk i ke pas shënimet ndoshta me i analizu të gjitha sepse ne i kemi pas edhe të parkut të biznesit që kanë qenë të muajit shkurt të vitit të kaluar, kanë qenë të hyra të realizuara drejt për drejt, këto janë të hyra të komunës por nuk janë të realizuara drejt për drejt prej neve, për ata kemi ndryshimet.

Burim Bujupi, të shpenzimet e buxhetit komunal të programet dhe nën programet të shërbimit publike dhe emergjente të tabela numër 3 shpenzimet për përdhën janar-mars kanë qenë 42.591.27 € që i bien 20 % ndërsa ju e keni shkru të buxheti final 100% që i bien që të gjitha pagat janë harxhuar.

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku, nuk e ke lexuar mirë, sepse ndarja e buxhetit apo alokimi të pagat është 42.591.27€ edhe shpenzimi është i njëjti për këtë arsye ka dal përqindja qind për qind.

Burim Bujupi, pyeti edhe për subvencionet në Drejtorinë e Bujqësisë këto mjete të shpenzuara a janë për këto serat e fundit që janë ndare apo ku janë bërë këto shpenzime për periudhën janar – mars?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, si përket serave ende nuk i kanë marrë sepse një herë është koha e afatit të ankesave dhe nuk janë kry, nuk janë bërë shpenzimet sepse akoma nuk është zhvillu si projekt.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pas disa diskutimeve hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota për, 00 vota kundër, 00 vota abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Raport i ndihmave dhe subvencioneve për vitin 2020.**

Drejtori i Financave-Shyqeri Bublaku, edhe kjo është një praktik e cila u bë që tri vite, kemi filluar me raportimin e ndihmave që ndahen nga Komuna e Drenasit për qytetaret e komunës, bujqit, dhe kategoritë tjera, ndarja e këtyre subvencioneve behet në bazë të rregullores të Kuvendit Komunal e cila është e hartuar në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale. Zyra e kryetarit gjatë vitit 2020 ka ndihmuar tre student me vlerë prej 1500 €, Drejtoria për Shërbime publike për vitin 2020 ka subvencionuar në vlerë prej 6273.69 €, këto janë kryesisht qytetare të

komunës të cilët janë dëmtuar nga fatkeqësitë elementare psh vërshimet, zjarret. Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural ka subvencionuar ne shume prej **48,348.47 €**, grupet të cilat janë subvencionuar janë furnizimi me centrifuga për bletari, sera për gra të marginalizuara, fermer të cilët janë furnizuar me mikser për ushqimin e kafshëve dhe fermer që janë furnizuar me sera, këto janë disa që janë furnizuar nga drejtoria e Bujqësisë. Drejtoria për zhvillim ekonomik ka subvencionuar firma iu është dhënë pronë komunale me qira janë liruar nga taksat bizneset sipas nenit 13 të rregullores komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba, 41 bizneseve janë dhënë prona komunale ne shfrytëzim për të shkurta kohore të në parkun e biznesit, janë ndihma që komuna iu ka afri bizneseve për me zhvilluar biznesin, duke marrë parasysh që viti 2020 ka qenë vit pandemik Komuna e Drenasit iu ka nda pako ushqimore dhe pako higjienike që ju kane ndarë qytetareve të cilët kanë qene të prekur nga covid-19 të cilët kanë qenë të mbyllur, dhe shuma e ndarë për vitin e kaluar është **204.000.40 €** dmth ka qenë furnizimi i pakove ushqimore dhe higjienike për pandemi, miell për skamnor, 50 familje me banim social ku iu ka heq qiraja për banim social për vitin 2020. Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport për vitin 2020 ka subvencionuar ne shumë prej **79.700.000 €**, ku ka subvencionu klube sportive, klube shoqëror-kulturore dhe artistike, klube shkrimtarë, shuma totale nga Komuna e Drenasit, drejtoria e arsimit shuma e ndare prej 92 mije euro për student janë dhënë bursa për student dmth shuma prej 92 mije euro për vitin 2020. Shuma e subvencioneve për vitin 2020 nga Komuna e Drenasit prej 270 mijë sa ka qene buxheti i planifikuar e kemi rrit shumen me **430.330 .64 €**.

Burim Bujupi, të Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim rural subvencionimi i vlerës **48,348.47 €**, do të ishte mirë me qenë një tabelë me tregu se sa janë shku shpenzim për centrifug, me i cek pak ma saktë se u kanë shkuar këto mjete, dhe të shuma e subvencionimit për vitin 2020 në vlerë prej 430 mije euro tek pronat në shfrytëzim ''Kosova Display.. për pesë vite e kishte pas pronën në shfrytëzim i ka kaluar afati i shfrytëzimit nuk e paske cek këtu qe i ka kaluaru, Xhevdet Zariqit i ka kalu afati i pronës komunale në shfrytëzim, NTP Besi, NTP Florianit, Fer Petrolit , kërkoj që ky material të përmirësohet për mbledhje të kuvendit.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, gjitha ato që i përmende ju ka kaluar afati i kemi njoftuar me vendim që ju ka skadu afati. Është bërë gabim teknik, ne kadastër janë hequr dhe ju kam njoftuar me vendim, dhe mundeni me kërkuar edhe ju vetë që me e shiku.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj ,Pas disa diskutimeve hodhi këtë pikë te rendit të ditës, me rekomandim që të korrigojohet lista e kësaj pike të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar ku votuan me:

07 vota për, 00 vota kundër, 00 vota abstenim.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës: **4.Propozim Vendimi për bartjen të hyrave vetanake nga viti 2020, në vitin 2021.**

Drejtori i Financave Shyqeri Bublaku, viti 2020 ka qenë një vit ku kemi realizuar të hyra të cilat nuk janë shfrytëzuar qatë vitit 2020 dhe janë bartur gjatë vitit 2021 sepse të hyrat vetanake nuk merren dmth i lejohet kuvendit komunal në shfrytëzim edh pasi të përfundon viti fiskal, shuma e përgjithshme e cila duhet të barten me propozim vendim është **1.135.436.89 €** shpërndarja e bartjes se këtyre do te behet sipas shumave për kategori ekonomike, dmth për

mallra shërbime kemi shumen prej 36.122.04 €, për subvencione dhe transfere: 18.362.04 € dhe për investime kapitale 1.80.952.81 €, kjo shpërndarje bëhet sipas drejtorive dhe zyrës komunale dmth mallra dhe shërbime i kemi në shëndetësi shuma prej 11.999.17 €, në arsim parashkollor dhe qedhet shuma prej 24.122.87 €, shuma totale është 36.122.04 €. Subvencionet dhe transferet zyra e kryetarit i ka 4.903.50 €, Drejtoria për Administratë shuma është 250.00 €. Drejtoria për infrastrukturë rrugore shuma prej: 92.94 €, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural shuma prej 1.912.30 €, Drejtoriati i Administratës Shëndetësi ne shume prej: 6.253.01 €, Drejtoriati për shërbime kulturore me shume prej: 600.39 €, Drejtoriati i Administratës- Arsim ne shume prej 4.349.90 €, gjithsej subvencione dhe transfere ne shumë prej 18.362.04 €. Ne kategorinë e investimeve kapitale e patëm shumen prej 1.80.952.81 €, në infrastrukturë rrugore apo ne shërbime emergjente e kemi shumen bashkëfinancim shuma prej 764.00 €, renovimi i dhe mirëmbajtja e objektit të shërbimit të zjarrfikësve me shume prej 3.813.48 €, shpenzimi vertikal dhe horizontal të rrugëve në Drenas me shumë prej 1.640.40 €. Instalimi i ndriçimit publik dhe riparim i rrjetit me nr të projektit me shume prej 19.723.01 €. Shuma totale në infrastrukturë rrugore është 19.723.01 €. Në programin e drejtorisë për Infrastrukturë publike me nen programin do të barten në këtë kod funksional (0451) këto projekte: ndërtimi i kolektorëve ne shume prej 80.000.00€. rregullimi i infrastrukturës trotuar dhe ndreqim publik në Komunën e Drenasit me shumë prej 130.000.00€ . Infrastruktura në Komoran I II III IV me numër të projektit (48628) në vlerë prej 50,000.00€ Asfaltimi i rrugës ne fshatin Gllanasellë, Godanc me numër të projektit (48632) në vlerë prej 40,000.00€. Asfaltimi i Rrugës në fshatin Terstenik I dhe II me numër të projektit (48633) në vlerë prej 50,000.00€ Asfaltimi i rrugës ne fshatin Dobroshec, Çikatovë e Vjetër me numër të projektit (48638) në vlerë prej 30,279.10€. Asfaltimi i rrugës në fshatin Baice Krajrove Damanek me numër të projektit (48640) në vlerë prej 50,000.00€ Ndërtimi i Infrastrukturës në fshatin Nekoc, Kishnarek me numër të projektit (48641) në vlerë prej 40,000.00€ Asfaltimi i rruges ne fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq me numer të projektit (48646) në vlerë prej 40,000.00€. Asfaltimi i rrugës Shtuticë, Verboc dhe Polluzhë me numer të projektit (48653) në vlerë prej 50,000.00€ Asfaltimi i Rrugës në Fshatin Llapushnik Poterrk Vukovc me numër të projektit. (48656) në vlerë prej 50,000.00€. Ndërtimi i Urave Turbinave dhe mureve mbrojtëse me numër të projektit (49187) në vlerë prej 50,000.00€ Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrugëve te asfaltuara në Drenas me numër të projektit (49188) në vlerë prej 80,000.00€. Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit me numër të projektit (49189) në vlerë prej 50,000.00€. Totali për bartje ne Drejtoratin për Infrastrukturë Publike nga fondi burimor është 790.279.10 €, këto janë projekte dy vjeçare që janë punuar vitin e kaluar por është këtë vit. Në Drejtoratin Shërbimet kadastrale dhe Gjeodezi (650) në në-programin (65005) me kod funksional (0610) këto të hyra, të barten në investime kapitale si vijon: Shpronësimi me numër të projektit (47969) me shumë prej: 193.883.87€. Në Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi, 660 në nën-programin (66310) me kod funksional (0620), këto të hyra të barten në investime kapitale si vijon: Mirëmbajtja e sistemit të adresave dhe vendosja e tabelave me numër të projektit.(49185) me shumë prej:461.83€ Totali për bartje në Planifikim Urban dhe Mjedis 461.83€. Në Drejtorati për Shërbimet Kulturore (850) nën-programi (85001) me kod funksional (0820) do të barten në investime kapitale si vijon: Renovimi i objekteve sportive me nr,të proj. (49182) me shumë prej:16.157.35 €. Fushat sportive dhe rekreacion me nr.te proj.(49183) me shumë

prej:39.802.50€. Totali për bartje në Drejt. për Shërbimet Kulturore 55.959.85€.Në programin e Administratës së Arsimit dhe Shkencë (920) nën-program (92005) me kod funksional(0980),do të bartën këto mjete në investime kapitale si vijon: Rrethoja e oborreve të shkollave me nr, të proj. (48240) me shumë prej: 5.215.00 €.Riparimi i nxemja qendrore (radiator dhe pajisje tjera përcjellës , me nr.te projektit (49197) me shumë prej:15.430.15 €. **Totali në investimi kapitale në Administratën e Arsimit 20.645.15€.**Mallra dhe shërbime 36.122.04 €, Subvencione dhe transfere18.362.04 €

-Investime kapitale 1.080.952.81 €

Totali për bartje nga fondi burimor 21-22 në vitin 2021: 1,135.436.89€

Burim Bujupi, pyeti: për fshatin Arllat 40 mijë euro që kanë me u bë bartje a është rruga e cila është e shtruar me zhavor që ka mbet pa u shtruar asfalti, projekti i vitit 2020 sigurisht, edhe të fushat sportive, cilat fusha janë?

Kryesuesi e Kuvendit Komunal - Labinot Halilaj, është projekt dy vjetar. Pasi që nuk pati diskutime tjera edhe këtë pikë të rendit të ditës e rekomandoj për Kuvend.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11:08 min

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenies Sociale

66 Nr 052-1987 dt 17.05 2021

**RAPORTI I PËRDITËSUAR EPIDEMIOLOGJIK I KOMUNËS SË DRENASIT LIDHUR ME
PANDEMINË ME COVID-19 (vir.SARS-COV2) MARS - MAJ 2020-2021
SI DHE PROCESI I DERITASHËM I IMUNIZIMIT - (VAKSINIMIT)**

DRENAS, MAJ 2021




Situata Epidemiologjike në Komunën e DRENAS-it lidhur me PANDEMINË COVID-19, nga Marsi 2020
deri Maj 2021

Nr.Infe.D/J Maj/ditë		
1	16	15

17.05.2021

Gjithsej raste TEST POZITIVE SARS-COV-2	1865	100.00%
Gjithsej raste AKTIVE SARS-COV-2	54	2.90%
Gjithsej raste te SHERUARA	1742	93.40%
&EX&	69	3.70%


Mesatarja Nr.Infeksionit JAVORË 2021	25.2				
Mesatarja Nr. infeksioneve Ditore (Shkurt 2021):	3.6				



Epidemiologjia me Test Pozitiv në SARS-CoV2 sipas grup moshave 2020-2021 Drenas


Drei 20 vjeç		21 deri 40 vjeç		41 deri 60 vjeç		61 deri 80 vjeç		mbi 80 vjeç	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
49	44	376	307	355	284	198	199	40	13
93		683		639		397		53	
1865									

Grafika e rasteve Test Pozitiv me SARS-CoV2 sipas grup moshave 2020-2021 Drenas



Janar 2020	0
Shkurt 2020	0
Mars 2020	0
Prill 2020	2
Maj 2020	0
Qershor 2020	26
Korrik 2020	168
Gusht 2020	150
Shtator 2020	52
Tetor 2020	88
Nëntor 2020	304
Dhjetor 2020	328
Janar 2021	142
Shkurt 2021	92
Mars 2021	245
Prill 2021	229
Maj 2021	39
Qershor 2021	


Përfshirja e gjinisë me SARS-CoV2 sipas muajve



VDEKSHMËRIA - MORTALITETI në CoV-19 / Drenas 2020-2021


Deri 20 vjeç		21 deri 40 vjeç		41 deri 60 vjeç		61 deri 80 vjeç		mbi 80 vjeç	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
0	0	2	0	7	4	25	20	8	3
0		2		11		45		11	
69									

Vdekshmëria sipas grup moshave nga CoV-19 / Drenas 2020-2021



Mortaliteti sipas gjinisë CoV-19 Drenas 2020-2021

■ Totali: M ■ Totali: F





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 02404-19925 dt. 17/05 2021

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 33 paragrafi 8 të Kodit të Etikes Nr. 12-070/01-51560, miratuar në Kuvendin e Komunës së Drenasit me datë 26.11.2020, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kuvendi i Komunës së Glogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021, të aprovoi këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikes

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim caktohen anëtarët e komisionit për monitorimin e Kodit të Etikes, në këtë përbërje:

1. _____, anëtar nga ekzekutivi;
2. _____, anëtar nga legjislativi;
3. _____, anëtar nga legjislativi;
4. _____, qytetar me integritet të dëshmuar;
5. _____, qytetar me integritet të dëshmuar.

Neni 2

Komisioni i Etikes monitoron zbatimin e kodit, dhe vepron sipas propozimeve individuale për përcaktimin e ekzistimit të një shkelje të kodit, paraqet raporte në kuvendin e komunës me rekomandime dhe ka kompetenca të tjera të përcaktuara me kod.

Neni 3

Mandati i komisionit të Etikes lidhet me mandatin e legjislaturës aktuale.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.


Kryetari i Komunës
Ramir Lladrovci